




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PER ARSIM

Dt. 30.06.2020, Nr. 09-111-22998



Në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nenit 18, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, nenit 35 pika 1 e Ligjit nr.04/l-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr.15/2019 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zv.Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, Drejtori i Drejtoratit për Arsim, shpallë:

K O N K U R S
PËR PLOTËSIMIN E POZITËS SË PUNËS

I. Titulli i vendit të punës: Drejtor në SHFMU''Rasim Kiçina'' - Drenas.

Lloji i vendit të punës: **Me mandat**
Numri i Pozitave : **1 (një) pozitë**
Kategoria Funksionale: **Nivel drejtues**
Koeficienti: **7.8**
Kohëzgjatja e emërimit: **Katër (4) vjet**

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

Detyrat kryesore të punës:

1. Drejtori i institucionit edukativo –arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:
 - 1.1. Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës
 - 1.2. Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe rrespektimin e kodeve të ndërlydhura të praktikës, sigurimi dhe përditësimi i të dhënave të nevojshme gjatë tërë vitit shkollor
 - 1.3. Detyrat e caktuara për zgjedhjen e mësimitdhënësve .vlerësimin e mësimitdhënësve ,disciplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me mësimitdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit
 - 1.4. Mbështetjen dhe mbikqyrjen e zbatimit të Kurrikulës
 - 1.5. Mbështetjen dhe mbikqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorve profesional të institucionit edukativo-arsimor
 - 1.6. Bashkëpunon me Këshillin Drejtues të institucionit edukativo – arsimor(KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimtarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo-arsimor

1.7. Raporton dy herë në vit para KDSH-s

1.8. Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit në institucionin edukativo-arsimor, duke përfshirë edhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve

1.9. Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë (MASHT)

1.10. Çështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim

1.11. Vlerësimi i performancës së drejtorit do të bëhet me Udhëzim Administrativ (UA) përkatës bazuar në standardet e praktikës profesionale të drejtorëve

Kushtet:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin Bachelor katërvjeçar prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licensim të mësimdhënësve, ose të jetë në procedure të licensimit;
4. Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të aprovuar nga MASHT sipas rekomandimeve të KSHLM, **e noterizuar ose e vërtetuar**;
5. Të kenë 4 vite përvojë pune në procesin edukativo – arsimor;

Aplikacioni duhet të përmbajë:

1. Dokumentet personale (certifikatën e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
2. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës, duhet të jetë e profilit arsimor, në bazë të normativit profesional për arsim të përgjithshëm, **e noterizuar ose e vërtetuar**;
3. Certifikatat e trajnimeve të përfunduara;
4. Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licensimit;
5. Dëshmi të përvojës së punës në arsim;
6. Portfolion profesionale (sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr.15/2019 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zv. Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar);
7. Letër referencë me përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake nga një institucion publik-kredibil (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli Drejtues i institucionit edukativo-arsimor, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë dhe individë me të cilët ka punuar ngushtë në programe të ndryshme për arsim);
8. Konceptin e Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor për të cilin ka konkuruar. Koncepti duhet të bazohet në fushat e cilësisë në arsim dhe të ketë 5-10 faqe tekst (një faqe për një fushë, me hapsirë 1.5, fonti I shkronjave 12, arial). Koncepti dorëzohet si pjesë e portfoljos, por është edhe pjesë përbërëse kryesore e intervistës;
9. Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësor- origjinale;
10. Dëshminë se nuk është nën hetime - origjinale.

Data e shpalljes së konkursit: 01.07.2020 deri me dt.15.07.2020.

Aplikacioni për konkurim merret në zyrën e DKA-së, kati i parë, sporteli nr. 10-12, Formularët të plotësohen rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentacioni i kompletuar, dorëzohet në arkivin komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit të konkurimit nuk do të shqyrtohen.


Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes në shtypin ditor dhe në web faqen e Komunës së Drenasit.

Drenas,

Më:30.06.2020



Drejtör për Arsim


Muhamet Gjoka